


5.3 STUKO PËR PATINIME

ACRYL SPACHTEL



Njësia matëse	copë/paletë	Konsumi	Ngjyra/specifikime të tjera
15 kg/thes	80 cp/paletë	1kg/m ²	E Bardhë



ACRYL SPACHTEL

Stuko patinimi e prodhuar në bazë të nano teknologjisë për realizimin e rifiniturave të lëmuara në ambiente të jashtme dhe të brendshme.

KARAKTERISTIKAT TEKNIKE

- Stuko Patinimi e përbërë nga çimento e bardhë, pluhur mermeri i bardhë, rezina dhe aditivë special.
- E prodhuar në bazë të nanoteknologjisë.
- Përdoret për ambiente të brendshme dhe të jashtme.
- Lejon një trashësi nga 0 deri 3 mm për çdo dorë.
- Fërkohet lehtësisht me letër zmerile dhe jep një rifiniturë të fortë dhe shumë të lëmuar.
- Është konform normës EN 998 - 1

FUSHAT E APLIKIMIT

Për stukimin e mureve dhe tavaneve të mbushura me llaç tradicional ose me llaç të parapërgatitur me bazë gëlqere - çimento.

- Stukimin e sipërfaqeve prej betoni.
- Për krijimin e rifinirurave të lëmuara në ambiente të jashtme dhe të brendshme.

PËRGATITJA E SUPORTIT

Suportet që karakterizohen nga disnivele më shumë se 3 mm, duhet të nivelohen paraprakisht përpara aplikimit të stukos. Suportet duhet të jenë të niveluara dhe mekanisht të qëndrueshme, të pastra, pa praninë e bojrave, yndyrave, etj.

MËNYRA E APLIKIMIT TË PRODUKTIT

Produkti përhapet në sipërfaqe nëpërmjet një spatule të lëmuar për të siguruar një përhapje dhe mbulim të plotë të sipërfaqes. Produkti aplikohet në dy duar deri në një trashësi në 3 mm. Dora e dytë jepet pasi të jetë tharë e para për 2 - 3 orë në temperaturë 23°C.

PASTRIMI I PRODUKTIT

Pastrimi i veglave të punës dhe i duarve duhet të bëhet kur produkti është tharë plotësisht.



TË DHËNAT TEKNIKE (NË +23°C DHE 50% U.R.)

Forma	Pluhur
Ngjyra	E Bardhë
Ruajtja	12 muaj në paketim origjinal në vend të thatë
Djegshmëria	I padjegshëm
Raporti i përzierjes	4.5 - 5 litra ujë për 15 Kg Acryl Spachtel
Kohëzgjatja e përzierjes	4 - 5 orë
pH i përzierjes	12
Temperatura e aplikimit	+5°C deri në +35°C
Trashësia maksimale në një dorë	1 mm
Koha për dorë të dytë	pas 60 - 90 min
Koha e pritjes për fërkim	24 orë
Koha e pritjes për lyerje	3 - 4 javë

TË DHËNA PËRFUNDIMTARE

Rezistenca në shtypje	≥ 5.5 N/mm ²
Rezistenca në përkulje	≥ 2,0 N/mm ²
Forca ngjitëse në beton	≥ 1,0 N/mm ²